



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 30 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 3176 prot., datë 11.06.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me kërkesën tuaj nëse pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm janë zhvilluar procese gjyqësore në pesë vitet e fundit për veprat penale të genocidit, krimeve kundër njerëzimit, shpërndarjes kompjuterike të materialeve pro genocidit ose krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës, nga verifikimi në bazën e të dhënave të portalit www.gjykata.gov.al, nuk rezulton të jetë regjistruar asnjë çështje gjyqësore për veprat penale të mësipërme. Për çdo çështje gjyqësore me interes për ju mund të aksesoni në portalin e gjykatave www.gjykata.gov.al, duke filtruar sipas akuzave të veprave penale.

Në lidhje me pyetjen e shtruar nëse ka struktura të posaçme gjyqësore për veprat penale të përmendura më lart, neni 74 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se kompetente për gjykimin e veprave penale janë gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, përveç veprave penale që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Pra, edhe për kategorinë e veprave penale që ju kërkoni informacion kompetente janë gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Aktualisht, pjesa më e madhe e tyre gjykojnë të ndara në seksione civile dhe penale, e veprat penale të mësipërme gjykojnë nga seksionet penale. Ndërsa, në gjykatat ku nuk është e mundur ndarja e gjyqtarëve në seksione, të gjithë gjyqtarët mund të gjykojnë veprat penale të mësipërme.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!